Gjimnazi "Loyola" në Prizren kremtoi katërvjetorin e themelimit

Shembull i mirë për shkollat tjera

ANITA KADRIU

Prishtinë, 16 prill - Nxënësit e gjimnazit "Loyola" në Prizren kanë treguar në katërvjetorin e themelimit të kësaj shkolle se çfarë është arsimimi sipas standardeve evropiane. Me njohuri të dy e më shumë gjuhëve të huaja, njëkohësisht të dëshmuar edhe për talent në artin muzikor apo atë të pikturës, nxënësit kanë dëshmuar cilësinë e lartë arsimore që arrihet në gjimnazin "Loyola". Drejtori Walter Happel, në hapjen e ceremonisë të kremtimit të katërvjetorit të themelimit të kësaj shkolle në Kosovë, ka falënderuar donatorët gjermanë një pjesë e të cilëve ishin prezentë në këtë solemnitet për mbështetjen financiare që i bëhet gjimnazit "Loyola" në krijimin e një të ardhme të sigurt për rininë e Kosovës. Edhe përfaqësuesi i kontingjentit gjerman

të KFOR-it, gjenerali Starlinger, ka vlerësuar këtë gjimnaz si një projekt mahnitës. "Është një investim për të ardhmen e vendit dhe të kapitalit më të çmuar të Kosovës, pra të rinisë, të cilët kryejnë këtu një shkollim sipas standardeve evropiane. Nxënësit e kësaj shkolle kanë treguar në shumë gara ndërkombëtare se nuk janë vetëm të mirë, por vlerësohen si ndër më të mirët", tha Starlinger. Ai tha se këtë e ka vërtetuar edhe personalisht kur nxënësit e kësaj shkolle me një gjermanishte dhe anglishte shumë të mirë i kanë treguar se çka kanë mësuar në lëndën e biologjisë. "Politikanët si dhe ndërmarrësit këtu në Kosovë janë të detyruar që të krijojnë kushte dhe vende punësimi për ta, pasi të përfundojnë studimet".

Nxënësit e gjimnazit "Loyola" mund të fitojnë diplomën e gjuhës gjermane (C1), njërin nga parakushtet më të rëndësishme për të studiuar jashtë vendit, aty ku flitet gjermanishtja. Shtatë prej nxënësve të kësaj shkolle për sukses të treguar janë pajisur me këto diploma të enjten. Në shumë klasë nxënësit kanë prezantuar për prindërit dhe mysafirët punimet e tyre dhe eksperimente të ndryshme. Por edhe profesorët kanë mbajtur nga një orë mësimore me nxënësit në prani të prindërve që të njoftohen me atë se çka mësojnë fëmijët e tyre, gjë e pazakontë deri më tash në shkollat e Kosovës.

Gjimnazit "Loyola", i vendosur në një hapësirë prej më shumë se tre hektarësh, bazuar në një arkitekturë moderne, të mahnit që në fillim nga pamja e jashtme me ndërtesa të reja, fusha sportive dhe pastërti e oborr të gjelbëruar. Investimi në këtë shkollë është siguruar nga asociacioni "Loyola" që vepron në Kosovë tash e gjashtë vjet. Gjimnazi "Loyola" në Prizren është gjimnaz privat klasik, i pranuar nga shteti, me një konvikt për vajza dhe një konvikt për djem. Megjithëse ka konfirmuar ardhjen dhe ka pasur mundësinë e rrallë të kënaqet me pamjen dhe cilësinë në arsim të nxënësve të kësaj shkolle në Kosovë, ministri i Arsimit, Enver Hoxhaj, nuk ishte prezent.

Kompanitë e transportit të kufomave i rrëqethin pacientët e QKUK-së

E reklamojnë vdekjen

ALBAN SELIMI

Prishtinë, 16 prill - Sa herë që hapej dera e mjekimit intensiv të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), kureshtja e Maliq Ramës rritej më shumë. Ai çdo çaste priste lajme për nipin e tij që kurohej qe disa ditë në Klinikën e Mjekimit Intensiv Qendror. Por, shikimi kah dritarja atij shpesh ia shuante shpresat. Reklama rrëqethëse të kompanive që transportojnë kufoma vazhdimisht vendosen në pikat më të ndjeshme të spitalit, aty ky jeta dhe vdekja bëjnë "luftë" ndërmjet tyre. Reklamat e këtyre firmave bëjnë që familjarët shpesh ta mendojnë më të keqen për të dashurit e tyre. "Po qysh s'asht keq për ne me i pa këto". Rama tregon se vetëm një ditë më parë i ka grisur disa nga to. Sipas tij, këta njerëz, që në momentet më kritike të afërmve ua reklamojnë vdekjen, janë të pashpirt. "Veç një njeri i pashpirt e bën këtë. Mua nëse më duhet transport i tillë, e gjej. Nuk është kjo reklamë për pushime verore - kush ofron kushte më të mira. Kjo është lojë me ndjenjat tona…". Rama tha se përgjegjësit e klinikave duhet që të mos i lejojnë këto kompani që t'i vendosin reklamat e tyre nëpër spitale. Reklama të tilla ka thuajse nëpër të gjitha repartet. Ato ndodh që shpesh i largojnë punëtorët e sigurimit, mirëpo sapo ata largohen "dikush" sërish i rivendos. Një punonjës i sigurimit të QKUK-së, pa dashur që emri t'i përmendet në gazetë, tha se shpeshherë i largon ato. Por, sa e kthen shpinën, ato sërish vendosen. "Nuk vijnë vetëm prej kompanive për t'i vendosur. Ka raste që ato vendosen edhe nga punonjës të spitalit, që kanë marrëveshje me ta", tha ky punëtor. Drejtori ekzekutiv i QKUK-së, Jusuf Ulaj, tha se, pasi e ka marrë në dorë udhëheqjen e kësaj qendre, ka urdhëruar që veturat e transportit të kufomave të mos parkohen para Emergjencës, urdhër ky që, sipas tij, po respektohet në përpikëri. "Nëse e keni vërejtur, prej ardhjes sime këtu veturat për transportin e kufomave vendosen jashtë oborrit të QKUK-së". Ulaj megjithatë konfirmon se vendosja e atyre reklamave nuk ndikon mirë as te pacientët, e as te familjarët. "Ndoshta reklamat i qesin aty-këtu. Unë nuk i kam vërejtur ato reklama", tha ai.

Edhe Blerim Nreci, pronar i kompanisë "Ngushëllimi", që merret me transportin e kufomave, pajtohet që nuk është e moralshme vendosja e reklamave në atë mënyrë. Por, ai tha se këtë "kulturë" e ka mësuar nga kompanitë e tjera që i vendosin reklamat e tyre në repartet e spitalit. "Unë kam filluar i fundit në Kosovë të merrem me këtë biznes. Kam punuar dhe vazhdojmë të punojmë në Gjermani. Atje do të dënoheshim nëse do t'i vendosnim reklamat në këtë mënyrë...". Sipas Nrecit, spitali do të duhej të krijonte një bazë ku do të raportoheshin vdekjet dhe nga baza, sipas radhës, kompanitë do t'i transportonin kufomat. "Me këtë rast, nuk do të kishte nevojë që të 'shtyheshim' mes vete, kurse spitali do të përfitonte hiç më pak se rreth 2000 euro në muaj". Ai është i vetëdijshëm që reklama që ka vendosur ndikon keq te pacientët, por tha se ajo shumë pak çon peshë në biznes. "Punonjësit e spitalit janë të lidhur me disa kompani, të cilat i favorizojnë dhe i thërrasin sapo të dëgjojnë se dikush ka vdekur". Nreci nuk përmend emra konkretë të punonjësve të QKUK-së që i thërrasin kompanitë, por thotë se e gjithë kjo bëhet me qëllime përfitimi të përbashkët.

(U kërkojmë ndjesë lexuesve për arsye se tema me titullin "E reklamojnë vdekjen" është paralajmëruar në ballinën e numrit paraprak të gazetës "Lajm", por për shkaqe teknike nuk është dalë)

Aty ku jeta dhe vdekja bëjnë "luftë" ndërmjet tyre, pacientët dhe familjarët e tyre rrëqethen nga reklamat e kompanive që transportojnë kufoma. Sado që grisen, ato rivendosen prapë

Reklamë e grisur e një kompanie për transport kufomash, e vendosur te Klinika Intensive

Veturat e transportit të kufomave nuk lejohet të kenë reklama

Derisa me asnjë ligj në Kosovë nuk precizohet mënyra e transportit të kufomave, e as nuk precizohet nëse lejohet reklama e këtyre kompanive, në komunikacion mjaft shpesh shihen vetura me reklama, e që transportojnë kufoma. Policia nuk di si të veprojë në këto raste, ndërkaq, sipas Blerim Nrecit, pronar i kompanisë "Ngushëllimi", veturat e transportit të kufomave nuk lejohen të kenë reklama. "Kompania jonë është e vetmja që nuk ka të vendosura reklama në veturat që transportojmë kufoma. Në Gjermani, apo në vendet e tjera të Perëndimit, po vendose reklamë, dënohesh nga policia", tha ai. Reklamat në vetura mund të ndikojnë te pjesëmarrësit në trafik dhe të shkaktohen incidente. "Mund të jetë dikush që frikësohet nga kufomat duke e ngarë veturën dhe në momentin që e shohin veturën me reklamë, edhe e humb kontrollin…". Nreci kërkon që shteti të vendosë rregulla edhe në këtë drejtim dhe të gjitha kompanitë të jenë të barabarta.